



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 782/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

### V E N D I M

I. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:

- Master i Mësimdhënies lëndore, MA, 120 ECTS ( me specializime: Matematikë; Fizikë; Biologji; Kimi; Histori; Gjeografi, Teknologji dhe TIK) (maksimum 40 studentë për vit akademik);
- Master i Pedagogjisë për Shkollat Profesionale, MA, 120 ECTS, (maksimum 40 studentë për vit akademik);
- Master i Edukimit Inkluziv, MA, 60 ECTS, (maksimum 40 studentë për vit akademik);

II. Kuotat e caktuar më sipër për regjistrim e studentëve në programet e studimit, vlejné nga viti akademik 2017/2018.

III. Obligohet Fakultetit i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me 1 tetor 2016 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2016/2017, për arsyeje të pensionimit të mundshëm te stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.

IV. Obligohet Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## A r s y e t i m i

Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Master i Mësimdhënies lëndore (specializimi: Matematikë; Fizikë; Biologji; Kimi; Histori; Gjeografi, Teknologji dhe TIK)	MA	120	Zeqir Shaqiri, Eda Vula, dhe Bahtije Gërbesh
2	Master i Pedagogjisë për Shkollat Profesionale	MA	120	Ruzhdi Kuqi, Kastriot Buza, dhe Fatlume Berisha
3	Master i Edukimit Inkluziv	MA	60	Ardita Devolli, Minavere Rashiti, dhe Violetë Bardhi

AKA ka organizuar vizitën në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” më 28.07.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Eve Eisenschmidt, Prof. Dr. Erwin Bratengeyer, Prof. Dr. Volker Frederking, Prof. Dr. Milan Pol.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25 Gusht 2016 ka vlerësuar aplikacionin e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë